REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE
SEKTORI I KUJDESIT SOCIAL DHE PAK

Nr. **Prot** **Bilisht më, . .2026**

PROJEKT – VENDIM
NR. 11 **, Date,** 22 . 01 **.2026**

"PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SE QENDRES SHUMEFUNKSIONALE KOMUNITARE DEVOLL DHE RREGULLORES SE QENDRES DITORE PER TE MOSHUARIT E CILA ESHTE NE VARESI TE QENDRES SHUMEFUNKSIONALE KOMUNITARE BASHKIA DEVOLL 2026–2027"

Në mbështetje të nenit 24 dhe 54 të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, nenin 36 të Ligjit Nr. 121/2016 "Për shërbimet të kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", I ndyshuar, Ligjit 22/2018 "Për strehimin social", I ndryshuar, ligjit Nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojten e Fëmijëve", Ligji Nr. 86/2017 "Për financat e vetëqeverjes vendore", I ndryshuar, Ligji Nr.64/2025 "Për barazinë gjinore", Ligji Nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar, Ligji Nr.10221/04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", i ndryshuar, VKM-së Nr. 224 datë 09.04.2024 "Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimet të kujdesit shoqëror". Ligjin Nr. 57/2019, "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", I ndryshuar Vendimin nr.823, date 06.12.2006 "Per Standartet e Sherbimeve te Perkujdesit Shoqeror, per te Moshuarit ne Qendrat Ditore. VKM nr. 518/2018 për kriteret dhe procedurat e shërbimeve komunitare dhe rezidenciale për persona në nevojë.

PROPOZOJ:

1. Miratimin e Rregullores se Qendres Shumfunksionale Komunitare per Bashkinë Devoll 2026-2027 sipas tekstit bashkangjitur këtij projektvendimi.
2. Miratimin e Rregullores se Qendres Ditore per te moshuarit e cila ndodhet ne Godinen e Nenprefektues, kjo qender eshte ne varesi te Qendres Shumfunksionale Komunitare Devoll.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social dhe Sektori i Planifikimit të Buxhetit.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar.

Konceptoi: Përgj. Qendres multfunksionale komunitare Devoll
Sofika Papa
Miratoi: Drejtor i Shërbimeve Sociale
Zerina Sinani
Konfirmoi bazën ligjore: Përgj. i sektorit Juridik dhe i prokurimeve
Eriksela Avdo
Konfirmoi: Sekretar i Përgjithshëm
Adriana Rushitaj

KRYETARI I BASHKISË
EDUARD DURO

Adresa: Bashkia Devoll, Lagja Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 9, Tel & Fax +355817123815-22288, e-mail: bashkiadevoll@gmail.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE
SEKTORI I KUJDESIT SOCIAL DHE PAK

Nr.213 **Prot** **Bilisht më,**22.01.**2026**

RELACION
Për projekt-vendimin
"PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SE QENDRES SHUMEFUNKSIONALE KOMUNITARE DEVOLL DHE RREGULLORES SE QENDRES DITORE PER TE MOSHUARIT E CILA ESHTE NE VARESI TE QENDRES SHUMEFUNKSIONALE KOMUNITARE
BASHKIA DEVOLL 2026–2027"

Në mbështetje të nenit 24 dhe 54 të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, nenin 36 të Ligjit Nr. 121/2016 "Për shërbimet të kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", I ndyshuar, Ligjit 22/2018 "Për strehimin social", ligjit Nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojten e Fëmijëve", Ligji Nr. 86/2017 "Për financat e vetëqeverjes vendore", I ndryshuar, Ligji Nr.64/2025 "Për barazinë gjinore", Ligji Nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar, Ligji Nr.10221/04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", i ndryshuar, VKM-së Nr. 224 datë 09.04.2024 "Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimet të kujdesit shoqëror". Ligjin Nr. 57/2019, "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë",Vendimin nr.823, date 06.12.2006 "Per Standartet e Sherbimeve te Perkujdesit Shoqeror, per te Moshuarit ne Qendrat Ditore. VKM nr. 518/2018 për kriteret dhe procedurat e shërbimeve komunitare dhe rezidenciale për persona në nevojë.

A)Qellimi: PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SE QENDRES SHUMEFUNKSIONALE KOMUNITARE DEVOLL.

Qëndra Shumëfunksionale Komunitare Devoll është një qëndër në shërbim të të gjithë komunitetit në Devoll e cila ka karakter social dhe ofron shërbime për të gjithë komunitetit vecanërisht grupeve vulnerable.Kategoritë për të cilat qendra është në funksion vijojnë si më poshtë:

1-Për persona me aftësi të kufizuar PAK

- Terapi Zhvillimi
- Terapi okupacionale
- Fizioterapi
- Vleresim Psiko-Social
- Mbeshtetje dhe ndihme sipas nevojave per fëmijët dhe familjen e tij;
- Edukim dhe rehabilitim;
- Nderhyrje sociale per te perfituar autonomi individuale per aktivitetet e perditshme, mbajtjen dhe ruajtjen e aftesive dhe integrimin e tyre.

Sherbimet sociale qe ofrohen ne qender mbeshteten ne kerkesat e standarteve te sherbimeve per personat me aftesi te kufizuara.Ne te gjitha rastet,synohet qe per cdo PAK te ofrohet nje program sherbimesh i vecante ne perputhje me nevojat e vleresuar nga punonjësit socialë me qellim qe të kene mundesi te zhvillojne shprehite e tyre dhe te maksiminalizojne potencialin nepermjet pjesemarrjes ne veprimtari te programuara nga punonjësit e qendres.

2-Për fëmijët kryesisht të komunitetit Rom/Egjiptian,fëmijë të cilët janë të pajisur me status jetimi,femijë me nje prind si dhe femijë të cilët vijnë nga kushte të vështira socio-ekonomike.

- After school/Detyrat e shtepise pas mesimit
- Keshillim psikologjik sipas rastit
- Aktivitete te ndryshme qe zhvillohen ne qender
- Perfitues te artikujve te ndryshem shkollor, lodra etj financuar nga Buxheti I Bashkise apo nga zbatimi i projekteve te ndryshem financuar nga donatore.

3- Për adoleshentë Kurse/Trajnime të ndryshme.

4- Për gra kryesisht të komunitet Rom/Egjiptian, gra viktima të dhunës në familje,gra të pa puna dhe që vinë nga kushtë të vështira ekonomike ofrohet shërbimi i:

- Keshillim psikologjik sipas rastit
- Trajnime integruese.

5- Strehez Emergjence 72 ore për akomodimin e kategorive si më poshtë:

- Persona të dhunes me baze gjinore.
- Persona të dhunes ne familje dhe femijet e tyre.
- Femijet pa kujdes prinderor dhe te dhunuar, te shfrytezuar, te abuzuar.
- Të moshuar të braktisur në situate rruge.

6-Për të moshuarit Qendra sherben si një Qendër Ditore për konsumimin e kafes dhe të cajit.

Shërbimet social-edukative në qendrën shumëfunksionale komunitare Devoll per femijet me aftesi te kufizuara sigurojnë :

- Programe psiko- socio-edukative per PAK me qellim rritjen e aftesive intelektuale, sociale dhe rritjen e pavaresise se funksioneve baze jetesore.

- Asistencë, edukim, rehabilitim;
- Ndërhyrje sociale për të përfituar autonomi individuale për aktivitetet e përditshme, mbajtjen, ruajtjen e zhvillimin e aftësive dhe integrimin e tyre ne familje e shoqeri.
- Mbështetje dhe sherbim për PAK dhe familjen e tij;

Si edhe çdo qëllim e program edukimi e rehabilitimi për arritjen e integrimit e përfshirjes së PAK në shoqëri që mund të ketë agjensia e shërbimit

Qendra Shumefunksionale Komunitare Devoll garanton llojet e sherbimeve tw meposhtme:

- Program individual për fëmijët me PAK Terapi Individuale/Grup
- Kujdes i vazhdueshem ditor.
- Sherbime per kryerjen e aktiviteteve ditore.
- Sherbime kreative, argetuese dhe mobilizuese.
- Sherbime terapeutike-rehabilituese-edukative, per te garantuar ruajtjen dhe rritjen e aftesive fizike ,sociale dhe privatesine individuale.

2. Objektivat e Qëndres Shumëfunksionale Komunitare Devoll

- Të ofrojë akomodim në përputhje me nevojat e PAK dhe plotesimin e kerkesave te programeve zhvilluese sipas standarteve te miratuara.
- Te ofroje nje mjedis te sigurt dhe mbeshtetes ku degjohen dhe inkurajohen qe te shprehin nevojat dhe dëshirat të gjithë kategoritë përfituese.
- Te nxise mundesite qe te arrijne potencialin e tyre te plote.
- Te nxise besimin dhe pavaresine e PAK.
- Te ofroje mundesi qe PAK te bejne zgjedhje.
- Te hartoje programe individuale te kujdesit per te permbushur nevojat e PAK ne perputhje me standartet e miratuara.
- Te siguroje nje bashkepunim eficent te personelit te qendres dhe me familjaret si dhe me persona te tjere

3.Vlerat e Qendres Shumëfunksionale Komunitare Devoll

Sherbimet ne Qender per personat me aftesi te kufizuara duhet te garantojne mbeshtetje te specializuar nga personeli ne nje mjedis te sigurt,dashamires dhe te rregullt . Qendra ka te gjitha pergjegjesite qe PAK te jene te mbrojtur nga keqtrajtimi,diskriminimi,lenia pas dore etj.Kujdesi duhet te jete pjese e sherbimeve qe ofrohen per te mbushur nevojat e PAK.

Qendra do të përzgjedhë personel të kualifikuar dhe do të zhvillojë shprehitë dhe praktikën profesioniale të stafi t nëpërmjet trainimit të vazhdueshën të tyre e pakta nje here ne vit. Në

filozofinë e qendrës dhe të personelit të saj qendra ka një numër vlerash që janë të rëndësishme për shtëpinë dhe për të cilët ofrohet kujdes si:

- **Dinjiteti dhe respekti**: Duke njohur vleren e femijeve me AK,vecantine dhe te drejten e tyre ,personeli i qendres angazhohet qe te trajtohen me dinjitet dhe respekt.

- **Barazia:** Sigurohet duke bere kujdes qe sherbimet ne qender te jene te arritshme dhe te disponueshme per te gjithe.Sherbimi i ofruar nga personeli do te mbeshtetet ne kerkesat e standarteve dhe jo ne rrethanat, ne te kaluaren dhe menyren e jeteses se PAK. Sherbimet do te garantojne mosdiskriminim per shkak te races, gjuhes, besimeve fetare gjinise,seksit

  ose aftesise se kufizuar. Sherbimet do te mbeshteten ne individualitetin e perfituesit dhe ne perkushtimin ,ndershmerine dhe profesionalizimin e personelit.
- **Cilesia:** Duke nxitur sherbime cilesore qe mbeshteten ne standartet e miratuara dhe permbushin kerkesat ligjore te praktikes me te mire te arritur.Angazhimi per te siguruar stafin qe punon per te realizuar objektivat e qendres ne baze te standarteve te miratuara.
- **Pavaresia**: Duke ju ofruar mundesi perfitueseve qe te mendojne dhe te veprojne ne menyre te pavarur,duke siguruar sigurine dhe intimitetin e tyre gjate gjithe kohes.
- **Te drejtat**: Qendra angazhohet ndaj PAK per te garantuar te drejtat dhe detyrimet e ligjshme ,te cilat parashtrohen ne Konventen e Kombeve te Bashkuara per te Drejtat e PAK.
- **Degjimi:** Angazhimi per te degjuar dhe ndihmuar per te shprehur te deshirat dhe nevojat e tyre, ne cdo lloj menyre qe i pershtatet me mire PAK.
- **Zhvillimi dhe realizimi**:Do te inkurajohen per te realizuar potencialin e tyre te plote dhe do te ndihmohen te realizojne shpresat dhe ambicjet per te zhvilluar aftesite e tyre ne jeten e perditshme.
- **Konfidencialiteti**: I gjithe informacioni personal i PAK do te trajtohet ne mirebesim.

B) PËR MIRATIMIN RREGULLORES SE QENDRES DITORE PER TE MOSHUARIT E CILA ESHTE NE VARESI TE QENDRES SHUMEFUNKSIONALE KOMUNITARE.

I. Hyrje dhe konteksti

Bashkia Devoll, në zbatim të detyrimeve ligjore për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe në funksion të përmirësimit të cilësisë së jetës për grupet në nevojë, ka ngritur Qendrën Ditore për të Moshuarit si pjesë përbërëse e Qendrës Shumëfunksionale Komunitare.

Rritja e numrit të personave të moshuar dhe nevoja për mbështetje sociale, shoqërore dhe komunitare, e bën të domosdoshëm organizimin e këtij shërbimi mbi bazën e rregullave të qarta, transparente dhe të standardizuara. Për këtë arsye, paraqitet për miratim Rregullorja e Qendrës Ditore për të Moshuarit, e cila synon të përcaktojë mënyrën e funksionimit, organizimit dhe ofrimit të shërbimeve ndaj përfituesve.

Hartimi i kësaj rregulloreje është bazuar në legjislacionin në fuqi, si dhe në praktikat e mira të ndjekura nga bashki të tjera në vend, të cilat kanë në funksion qendra ditore për të moshuarit si shërbim komunitar.

II. Qëllimi i rregullores

Qëllimi i rregullores është përcaktimi i rregullave të organizimit dhe funksionimit të Qendrës Ditore për të Moshuarit, e cila vepron në varësi të Qendrës Shumëfunksionale Komunitare të Bashkisë Devoll.

Rregullorja synon:

- garantimin e një shërbimi cilësor, të qëndrueshëm dhe të aksesueshëm për personat e moshuar;
- përcaktimin e qartë të të drejtave dhe detyrimeve të përfituesve të shërbimit;
- përcaktimin e përgjegjësive dhe roleve të stafit të qendrës;
- sigurimin e standardeve të funksionimit, etikës profesionale dhe mbrojtjes së dinjitetit të personave të moshuar;
- rritjen e transparencës dhe eficiencës në menaxhimin e shërbimit social.

III. Përmbajtja dhe rëndësia e rregullores

Rregullorja përcakton në mënyrë të detajuar:

- misionin dhe objektivat e Qendrës Ditore për të Moshuarit;
- kriteret e përfitimit dhe procedurat e pranimit të të moshuarve në qendër;
- shërbimet që ofrohen në kuadër të qendrës (shërbime sociale, aktivitete komunitare, mbështetje psiko-sociale, aktivitete kulturore dhe rekreative);
- oraret e funksionimit të qendrës;
- organizimin e stafit dhe detyrat e secilit funksion;
- rregullat e sjelljes, disiplinës dhe bashkëjetesës në ambientet e qendrës;
- masat për garantimin e sigurisë, shëndetit dhe mirëqenies së përfituesve.

Miratimi i kësaj rregulloreje siguron një kuadër të qartë funksionimi dhe ndihmon në rritjen e cilësisë së shërbimit të ofruar ndaj personave të moshuar.

IV. Përfitimet nga miratimi i rregullores

Miratimi i Rregullores së Qendrës Ditore për të Moshuarit sjell këto përfitime:

- rritjen e cilësisë dhe standardizimin e shërbimeve sociale për të moshuarit;
- përmirësimin e koordinimit dhe organizimit të punës së stafit;
- sigurimin e transparencës dhe barazisë në trajtimin e përfituesve;
- reduktimin e izolimit social dhe rritjen e përfshirjes komunitare të të moshuarve;
- forcimin e rolit të Bashkisë Devoll në ofrimin e shërbimeve sociale komunitare.

Në përfundim, miratimi i Rregullores së Qendres Shumfunskionale Komunitare dhe Qendrës Ditore për të Moshuarit, e cila funksionon në varësi të Qendrës Shumëfunksionale Komunitare të Bashkisë Devoll, përbën një hap të rëndësishëm në përmirësimin e shërbimeve sociale vendore dhe garantimin e një kujdesi dinjitoz, të organizuar dhe në përputhje me standardet ligjore për personat ne nevoje dhe personat e moshuar.

- Për sa më sipër, propozohet miratimi i te dyja rregulloreve nga Këshilli Bashkiak i Bashkisë Devoll.

  Ju faleminderit!

Konceptoi: Përgj.I Qendres Multfunksionale Komunitare Devoll
Sofika Papa
Miratoi: Drejtor i Shërbimeve Sociale
Zerina Sinani
Konfirmoi: Sekretar i Përgjithshëm
Adriana Rushitaj

KRYETARI I BASHKISË
Eduard DURO

Adresa: Bashkia Devoll, Lagja Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 9, Tel & Fax +35581123815-22288, e-mail: bashkiadevoll@gmail.com

MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

BASHKIA DEVOLL

RREGULLORE E

BRENDSHME E

FUNKSIONIMIT TË

QENDRËS

DITORE PËR TË

MOSHUARIT

DEVOLL

2026-2027

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

BASHKIA DEVOLL

RREGULLORE E BRËNDSHME E FUNKSIONIMIT TË QENDRËS DITORE PËR TË MOSHUARIT,DEVOLL.

1. Dispozitat e Përgjithshme

Qendra Ditore për moshën e tretë ka si mision të ofrojë shërbime sociale, mjekësore, argëtuese dhe edukative për të mbështetur dhe përmirësuar cilësinë e jetës së të moshuarve. Kjo rregullore percakton rregullat dhe procedurat per funksionimin e qendrës, duke garantuar nje ambient te sigurt, te ngrohte dhe motivues per zhvillimin e aktiviteteve te ndryshme shoqerore, kulturore, shendetsore dhe rekreative.

Qendra Ditore për të Moshuarit përbën një shërbim komunitar me rëndësi të veçantë për mbështetjen sociale, përfshirjen aktive dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së personave të moshuar. Për funksionimin e rregullt dhe të qëndrueshëm të këtij shërbimi lind nevoja për një rregullore të brendshme, e cila të përcaktojë qartë mënyrën e organizimit, ofrimit të shërbimeve, të drejtat dhe detyrimet e përfituesve, si dhe përgjegjësitë e stafit.

2. Parimet themelore

Funksionimi i Qendrës Ditore për të Moshuarit bazohet në parimet e mëposhtme:

- Respektimi i dinjitetit, autonomisë dhe individualitetit të çdo anëtari;
- Promovimi i pjesëmarrjes aktive të të moshuarve në jetën komunitare dhe aktivitetet e qendrës;
- Garantimi i një ambienti miqësor, përfshirës, të barabartë dhe të sigurt;
- Mosdiskriminimi dhe trajtimi i barabartë i të gjithë përfituesve;
- Nxitja e bashkëpunimit, solidaritetit dhe mirëkuptimit ndërmjet anëtarëve.

3. Orari i Funksionimit

Qendra do të funksionojë nga e hëna deri të premten, nga ora 8:00 – 13:00 paradite dhe pasdite 14:00 – 16:00.
Ne orarin e pasdites pasi te kete perfunduar orari zyrtar i punes, qëndra do te hapet nga perfaqësues të të moshuarve të zgjedhur nga anëtarët e qendrës.

4. Kalendari i Aktiviteteve per orarin e paradites.

Dita	Aktiviteti	Ora
E Hënë	Mirepresim te gjithe te moshuarit	08:00 - 09:30

	Pyesim lidhur me preferencat per te konsumuar kafe, caj apo kakao	09:30 - 10:30
	Sherbejme produktin e kerkuar nderkohe qe bashkebisedojme	10:30 - 11:30
	Loja e dominosë	11:30 - 13:00
E Martë	Mirepresim te gjithe te moshuarit	08:00 - 09:30
	Sherbejme caj , kafe apo kakao	09:30 - 10:30
	Loja me letra	10:30 - 11:30
	Zhvillojme lojra qe nxisin trurin dhe kujtesen	11:30 - 13:00
E Mërkurë	Matje tensioni	08:00 - 09:30
	Loje me domino	09:30 - 10:30
	Loje me letra	10:30 - 11:30
	Biseda me stafin	11:30 - 13:00
E Enjte	Festimi i ditëlindjeve (nëse ka)	08:00 - 10:00
	Konsumohet kafe dhe caj	10:00 - 11:30
	Loja e dominosë	11:30 - 13:00
E Premte	Ore sociale- diskutim rreth ceshtjeve te ndryshme me interes	08:00 – 09:00
	Konsumohet kafe dhe caj	09:00 - 10:00
	Bashkepunime me shkollat apo OJF (nese ka)	10:00 - 11:30
	Loja me kuba	11:30 - 13:00
Fundviti	Festa e Vitit te Ri	Sipas njoftimit
	Ekskursione ose aktivitete të jashtme	Sipas njoftimit
	Kampionati i dominosë (një herë në vit)	Sipas njoftimit

5. Rregullat e Pjesëmarrjes

- Të gjitha aktivitetet janë falas dhe të hapura për të gjithë pjesëmarrësit e regjistruar në qender.
- Pjesëmarrësit duhet të respektojnë oraret dhe të konfirmojnë paraprakisht pjesëmarrjen në ekskursione dhe festa.
- Sjellja e respektueshme ndaj stafit dhe pjesëmarrësve është e domosdoshme.
- Shërbimi i pijeve (si çaj, kafe, ujë etj.) do të ofrohet falas gjatë gjithë kohës.

6. Dispozitat për Kujdesin Shëndetësor

- Kontrolli i thjeshtë mjekësor ne qender ofron matjen e tensionit,diabetit, kontrollin e peshës dhe këshilla bazë.
- Vizitat mjekësore specifike planifikohen sipas nevojave individuale.

7. Masat për Sigurinë

- Ekskursionet organizohen me mjete transporti të sigurta dhe me shoqërim të stafit.
- Në rast emergjencash gjatë aktiviteteve, ndiqen procedurat e ndihmës së shpejtë.
- Të gjitha veprimtaritë festuese dhe ankandet monitorohen për të garantuar rregull dhe siguri.

8. Stafi i Qendrës

- **Kujdestari:** Kujdeset për administrimin e ambienteve të qendrës dhe ofron shërbime të pijeve (si çaj, kafe etj.) për pjesëmarrësit.
- **Punonjësja Sociale:** Organizon aktivitetet në qendër, realizon vizitat në shtëpi dhe siguron mbështetje sociale për të moshuarit.

9. Rregulla dhe Kufizime të Sjelljes në Qendrën Ditore

Për të siguruar një ambient të qetë, të shëndetshëm dhe të këndshëm për të gjithë anëtarët dhe vizitorët e qendrës, ju lutemi të respektoni rregullat e mëposhtme:

- **Ndalohet pirja e duhanit** brenda ambienteve të brendshme të qendrës.
- **Nuk lejohet konsumimi i pijeve alkoolike** brenda qendrës ose gjatë aktiviteteve të organizuara prej saj.
- **Lojërat e fatit dhe bixhozi janë të ndaluara** brenda qendrës dhe gjatë aktiviteteve të saj.
- **Respekti dhe sjellja e mirë** janë të domosdoshme në çdo komunikim mes anëtarëve dhe stafit.
- **Përdorimi i fjalorit të papërshtatshëm, sjelljet konfliktuale apo të dhunshme nuk tolerohen.**
- **Kujdesi për pastërtinë dhe mirëmbajtjen e hapësirave** është përgjegjësi e secilit anëtar.
- **Nuk lejohet sjellja e sendeve të rrezikshme ose substancave të ndaluara.**

Mosrespektimi i këtyre rregullave mund të sjellë masa kufizuese në shërbimet e qendrës, sipas vlerësimit të stafit përgjegjës.

10. Funksionimi i Qendrës gjatë Orarit të Pasdites (14:00 - 16:00)

Gjatë orarit të pasdites pas ores 16:00, nese qendra do të qëndrojë e hapur do të menaxhohet nga vetë anëtarët, është e domosdoshme respektimi i rregullave të mëposhtme për të siguruar një ambient të qetë, të sigurt dhe të mirëorganizuar:

1. **Përgjegjësia kolektive** – Të gjithë anëtarët janë të ftuar të kontribuojnë në mirëmbajtjen dhe rregullin e hapësirave, duke treguar kujdes ndaj pajisjeve dhe mjedisit.
2. **Respektimi i rregullave të sjelljes** – Edhe në mungesë të stafit mbikëqyrës, mbeten në fuqi të gjitha rregullat e sjelljes dhe kufizimet e përcaktuara në këtë rregullore.
3. **Siguria personale** – Secili anëtar është përgjegjës për sigurinë e tij dhe të të tjerëve. Në raste urgjente, duhet të kontaktohet menjëherë një person përgjegjës ose shërbimet përkatëse.
4. **Përdorimi i ambienteve** – Hapësirat dhe pajisjet e qendrës duhet të përdoren me kujdes dhe të lihen të pastra pas përdorimit.
5. **Ndalohet hyrja e personave të jashtëm** – Gjatë këtij orari, qendra është e hapur vetëm për anëtarët e saj, përveç rasteve kur ka miratim paraprak nga administrata.
6. **Përfundimi i aktiviteteve** – Në përfundim të orarit të pasdites (19:00), duhet të sigurohet që të gjitha hapësirat të jenë të pastra, të rregullta dhe të mbyllen sipas udhëzimeve të dhëna nga administrata e qendrës.

MIRATOI

KRYETARI I BASHKISË
EDUARD DURO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

BASHKIA DEVOLL

RREGULLORJA E BRENDSHME E QENDRËS SHUMËFUNKSIONALE KOMUNITARE DEVOLL

2026-2027

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

BASHKIA DEVOLL

1.Deklarata e qëllimit

Qëndra Shumëfunksionale Komunitare Devoll është një qëndër në shërbim të të gjithë komunitetit në Devoll e cila ka karakter social dhe ofron shërbime për të gjithë komunitetit vecanërisht grupeve vulnerable.Kategoritë për të cilat qendra është në funksion vijojnë si më poshtë:

1-Për persona me aftësi të kufizuar PAK

- Terapi Zhvillimi
- Terapi okupacionale
- Fizioterapi
- Vleresim Psiko-Social
- Mbeshtetje dhe ndihme sipas nevojave per fëmijët dhe familjen e tij;
- Edukim dhe rehabilitim;
- Nderhyrje sociale per te perfituar autonomi individuale per aktivitetet e perditshme, mbajtjen dhe ruajtjen e aftesive dhe integrimin e tyre.

Sherbimet sociale qe ofrohen ne qender mbeshteten ne kerkesat e standarteve te sherbimeve per personat me aftesi te kufizuara.Ne te gjitha rastet,synohet qe per cdo PAK te ofrohet nje program sherbimesh i vecante ne perputhje me nevojat e vleresuar nga punonjësit socialë me qellim qe të kene mundesi te zhvillojne shprehite e tyre dhe te maksiminalizojne potencialin nepermjet pjesemarrjes ne veprimtari te programuara nga punonjësit e qendres.

2-Për fëmijët kryesisht të komunitetit Rom/Egjiptian,fëmijë të cilët janë të pajisur me status jetimi,femijë me nje prind si dhe femijë të cilët vijnë nga kushte të vështira socio-ekonomike.

- After school/Detyrat e shtepise pas mesimit
- Keshillim psikologjik sipas rastit
- Aktivitete te ndryshme qe zhvillohen ne qender
- Perfitues te artikujve te ndryshem shkollor, lodra etj financuar nga Buxheti I Bashkise apo nga zbatimi i projekteve te ndryshem financuar nga donatore.

3- Për adoleshentë Kurse/Trajnime të ndryshme.

4- Për gra kryesisht të komunitet Rom/Egjiptian, gra viktima të dhunës në familje,gra të pa puna dhe që vinë nga kushtë të vështira ekonomike ofrohet shërbimi i:

- Keshillim psikologjik sipas rastit
- Trajnime integruese.

5- Strehez Emergjence 72 ore për akomodimin e kategorive si më poshtë:

- Persona të dhunes me baze gjinore.
- Persona të dhunes ne familje dhe femijet e tyre.
- Femijet pa kujdes prinderor dhe te dhunuar, te shfrytezuar, te abuzuar.
- Të moshuar të braktisur në situate rruge.

6-Për të moshuarit Qendra sherben si një Qendër Ditore për konsumimin e kafes dhe të cajit.

Shërbimet social-edukative në qendrën shumëfunksionale komunitare Devoll per femijet me aftesi te kufizuara sigurojnë :

- Programe psiko- socio-edukative per PAK me qellim rritjen e aftesive intelektuale, sociale dhe rritjen e pavaresise se funksioneve baze jetesore.
- Asistencë, edukim, rehabilitim;
- Ndërhyrje sociale për të përfituar autonomi individuale për aktivitetet e përditshme, mbajtjen, ruajtjen e zhvillimin e aftësive dhe integrimin e tyre ne familje e shoqeri.
- Mbështetje dhe sherbim për PAK dhe familjen e tij;

Si edhe çdo qëllim e program edukimi e rehabilitimi për arritjen e integrimit e përfshirjes së PAK në shoqëri që mund të ketë agjensia e shërbimit

Qendra Shumefunksionale Komunitare Devoll garanton llojet e sherbimeve tw meposhtme:

- Program individual për fëmijët me PAK Terapi Individuale/Grup
- Kujdes i vazhdueshem ditor.
- Sherbime per kryerjen e aktiviteteve ditore.
- Sherbime kreative, argetuese dhe mobilizuese.
- Sherbime terapeutike-rehabilituese-edukative, per te garantuar ruajtjen dhe rritjen e aftesive fizike ,sociale dhe privatesine individuale.

Qendra Shumëfunksionale Komunitare mund te ofroje kujdes njeherazi deri ***ne 9-10 PAK.***

Qëndra Shumëfunksionale Komunitare Devoll ofron sherbime te te dyja gjinive qe i perkasin moshes shkollore.

Te gjithe PAK qe kane kerkuar te vendosen ne qender qe ne fillim vleresohen nga punonjës të Drejtorisë së Shërbimit Social te cilet konsultojne historikun e PAK nepermjet studimit te dokumentacionit shoqerues si dhe intervistes me personat me aftesi te kufizuara dhe shoqeruesin

e tij familjar. Mbi kete baze ekspertet hartojne nje raport vleresues ku percaktohen nevojat e klientit dhe programin per rehabilitimin e tij.

2. Objektivat e Qëndres Shumëfunksionale Komunitare Devoll

- Të ofrojë akomodim në përputhje me nevojat e PAK dhe plotesimin e kerkesave te programeve zhvilluese sipas standarteve te miratuara.
- Te ofroje nje mjedis te sigurt dhe mbeshtetes ku degjohen dhe inkurajohen qe te shprehin nevojat dhe dëshirat të gjithë kategoritë përfituese.
- Te nxise mundesite qe te arrijne potencialin e tyre te plote.
- Te nxise besimin dhe pavaresine e PAK.
- Te ofroje mundesi qe PAK te bejne zgjedhje.
- Te hartoje programe individuale te kujdesit per te permbushur nevojat e PAK ne perputhje me standartet e miratuara.
- Te siguroje nje bashkepunim eficent te personelit te qendres dhe me familjaret si dhe me persona te tjere

ORGANIZIMI I SHERBIMEVE NE QENDER

Numri maksimal i klientëve në qendër, në të njëjtën kohë, është i barabartë me kapacitetin maksimal të qëndrës. Përzgjedhja e klientëve që do të vendosen në qendër përcaktohet në bazë të kritereve të vendosura nga SHSSH, proçedurave të parashikuara në manual, ose procedurave te vendosura nga vete Drejtoria e Sherbimit Social.

Qendra Shumëfunksionale Komunitare mund te ofroje kujdes njeherazi deri ***ne 9-10 PAK.***

Qëndra Shumëfunksionale Komunitare Devoll ofron sherbime te te dyja gjinive qe i perkasin moshes shkollore .

Te gjithe PAK qe kane kerkuar te vendosen ne qender qe ne fillim vleresohen nga punonjës të Drejtorisë së Shërbimit Social te cilet konsultojne historikun e PAK nepermjet studimit te dokumentacionit shoqerues si dhe intervistes me personat me aftesi te kufizuara dhe shoqeruesin e tij familjar. Mbi kete baze ekspertet hartojne nje raport vleresues ku percaktohen nevojat e klientit dhe programin per rehabilitimin e tij.

Terapitë e zhvillimit si rregull organizohen në grupe dhe individuale por duke patur parasysh numrin e femijeve me autizem si dhe menyren sesi femijet frekuentojne ose jo shkollen, eshte menduar qe sherbimet te ofrohen si me poshte:

Shërbime për fëmijë me çrregullime të spektrit të autizmit:

- terapi individuale dhe grupi e bazuar mbi parimet e terapise analizes se sjelljes
- sherbime me fokus autonomine dhe higjenen personale, aktivitete socializimi dhe rikreative-kulturore.

Shërbime për fëmijë me aftësi te kufizuara intelektuale (jo autizem):

- Terapi zhvillimi (rastet qe paraqesin veshtiresi ne arsimimin special),
- Terapi fizike (mosfunksioni motorik)
- Terapi okupacionale (fokus te mesuarit e nje zanati ne nivel bazik si p.sh. kopshtari, etj.)
- Sherbime rehabilituese, edukative për mbajtjen dhe rritjen e aftësive fizike dhe sociale (autonomia dhe higjena personale)
- Aktivitete të socializimit dhe rikreative-kulturore
- Mbështetje për familjen e PAK: trajnime dhe keshillime periodike, ne vecanti dhe ne grup, – me se pakti 1 here ne muaj-mbi aftesine e kufizuar perkatese dhe potencialet e femijes se tyre, ne menyre qe sherbimi te replikohet edhe ne shtepi nga ana e prindit.
- Informim, fuqizim dhe ndërgjegjësim për personat me aftësi të kufizuara, familjarët e tyre dhe komunitetin, avokaci, rrjetezim

4.Vlerat e Qendres Shumëfunksionale Komunitare Devoll

Sherbimet ne Qender per personat me aftesi te kufizuara duhet te garantojne mbeshtetje te specializuar nga personeli ne nje mjedis te sigurt,dashamires dhe te rregullt . Qendra ka te gjitha pergjegjesite qe PAK te jene te mbrojtur nga keqtrajtimi,diskriminimi,lenia pas dore etj.Kujdesi duhet te jete pjese e sherbimeve qe ofrohen per te mbushur nevojat e PAK.

Qendra do të përzgjedhë personel të kualifikuar dhe do të zhvillojë shprehitë dhe praktikën profesioniale të stafi t nëpërmjet trainimit të vazhdueshën të tyre e pakta nje here ne vit. Në filozofinë e qendrës dhe të personelit të saj qendra ka një numër vlerash që janë të rëndësishme për shtëpinë dhe për të cilët ofrohet kujdes si:

- **Dinjiteti dhe respekti**: Duke njohur vleren e femijeve me AK,vecantine dhe te drejten e tyre ,personeli i qendres angazhohet qe te trajtohen me dinjitet dhe respekt.

- **Barazia:** Sigurohet duke bere kujdes qe sherbimet ne qender te jene te arritshme dhe te disponueshme per te gjithe.Sherbimi i ofruar nga personeli do te mbeshtetet ne kerkesat e standarteve dhe jo ne rrethanat, ne te kaluaren dhe menyren e jeteses se PAK. Sherbimet do te garantojne mosdiskriminim per shkak te races, gjuhes, besimeve fetare gjinise,seksit

  ose aftesise se kufizuar. Sherbimet do te mbeshteten ne individualitetin e perfituesit dhe ne perkushtimin ,ndershmerine dhe profesionalizimin e personelit.
- **Cilesia:** Duke nxitur sherbime cilesore qe mbeshteten ne standartet e miratuara dhe permbushin kerkesat ligjore te praktikes me te mire te arritur.Angazhimi per te siguruar stafin qe punon per te realizuar objektivat e qendres ne baze te standarteve te miratuara.
- **Pavaresia**: Duke ju ofruar mundesi perfitueseve qe te mendojne dhe te veprojne ne menyre te pavarur,duke siguruar sigurine dhe intimitetin e tyre gjate gjithe kohes.
- **Te drejtat**: Qendra angazhohet ndaj PAK per te garantuar te drejtat dhe detyrimet e ligjshme ,te cilat parashtrohen ne Konventen e Kombeve te Bashkuara per te Drejtat e PAK.
- **Degjimi:** Angazhimi per te degjuar dhe ndihmuar per te shprehur te deshirat dhe nevojat e tyre, ne cdo lloj menyre qe i pershtatet me mire PAK.
- **Zhvillimi dhe realizimi**:Do te inkurajohen per te realizuar potencialin e tyre te plote dhe do te ndihmohen te realizojne shpresat dhe ambicjet per te zhvilluar aftesite e tyre ne jeten e perditshme.
- **Konfidencialiteti**: I gjithe informacioni personal i PAK do te trajtohet ne mirebesim.

Personeli:

- Krijimi i një mjedisi të ngrohtë.
- Komunikimi dhe etika.
- Konfidencialiteti.
- Dhënia e mundësive të barabarta për të gjithë PAK.
- Rritja e aftësivetë PAK për t'u integruar në shoqëri.
- Rritjen e aftësisë për të kryer funksionet bazike jetësore.
- Krijimin e marrëdhenieve pozitive me anëtarët e familjes dhe per informimin periodik te tyre.
- Respektoje dinjitetin dhe personalitetin e PAK
- Paanshmëria dhe pa paragjykime në marredheniet me përdoruesit e shërbimit.
- Ofrimi i shërbimit me përkushtim dhe profesionalizëm.
- Kryerja me përpikmëri dhe seriozitet e detyrës.
- Parandalimi, shmangia dhe raportimi me transparence në rastet e abuzimeve

3. Rregullore e brendshme e shërbimeve që ofron qendra ditore për fëmijët me aftësi të kufizuar

Në këtë rregullore parashtrohen detyrimet që kanë fëmijët me AK dhe personeli i qendrës.

1. Shërbimi i ofruar pranë qendrës ofrohet me rotacion. Oraret e rotacionit percaktohen ne baze te numrit te përfituesve që frekuentojnë qendrën duke patur gjithmonë si objektiv mundesimin e shërbimeve për të gjithe përfituesit. .
2. Kur fëmijët të vijnë për të marrë shërbimin në qendër do shoqërohen nga prindërit dhe do dorëzohen te personeli i qendrës.
3. Për cdo ditë një anëtar i stafit venoset për të dorëzuar fëmijët te prindërit.
4. Regjistrii hyrje-daljeve firmoset cdo ditë nga prindi në prani të stafit përgjegjës.
   Data ____/_____/_____

Nr.	EmërMbiemër	Ora e hyrjes	Emër/firma e prindit	Ora e daljes	Emër/firma e prindit	Firma e stafit

5. Stafi i qendrës, është një ekipmultidisiplinar i cili bën vlerësimet përkatëse të fëmijëve me AK dhe në bazë të tyre harton planin individual të zhvillimit.
6. Personeli i qendrës duhet të sigurojë që informacioni personal i fëmijëve me AK të ruhet konfidencial.
7. Personeli i qendrës duhet të angazhohet që të ofrojë shërbime të arritshme dhe të disponueshme për të gjithë target grupin e qendrës.
8. Personeli i qendrës duhet të angazhohet që të trajtojë me dinjitet dhe respekt fëmijët me AK.
9. Personeli i qendrës duhet të angazhohet që të respektojë të drejtat që parashtrohen në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e PAK.
10. Qendran dërton një plan të vecantë për lidhjet me familjarët dhe të afërmit dhe kujdeset që ata të vizitojnë qendrën sa here që kjo është e nevojshme.
11. Stafi ofron shërbim transparent dhe cilësor mbështetur në standartet e miratuara për Personat me Aftësi të Kufizuar dhe kërkesat ligjore.
12. Stafi duhet të dëgjojë dhe ndihmojë Fëmijët me Aftësi të Kufizuar të shprehin dëshirat dhe nevojat e tyre.

IV. MBROJTJA E PAK, UDHEZIME DHE PROCEDURA

Në raste të abuzimit fizik, emocional, seksual apo neglizhimi, vetë Personat me Aftësi Të Kufizuar ose me ndihmën e kujdestarit mund të bëjnë ankesat pranë Shërbimit Social Rajonal, Shërbimit Social Shtetëror ose Bashkisë në të cilën është në varësi qendra e fëmijëve me aftësi të kufizuar.

Stafi i qendres ka njohuri mbi koncepte si Abuzimi dhe neglizhimi, Abuzimi fizik, Abuzimi emocional, Abuzimi seksual, Neglizhimi dhe Ankesat. Hapat qe do ndjeke Qendra ne raste abuzimi jane ne perputhje me Manualin e Zbatimit te Standarteve te Perkujdesit Shoqeror per Femijet me Aftesi te Kufizuara:

- Trajnimi i rasteve të keqtrajtuara
- Mbajtja e informacionit
- Akuzat për abuzimin me PAK dhe proçedurat që ndiqen
- Referimi i informacionit i cili realizohet nepermjet 2 formulareve specifike:

Formularit 1: Proçes verbali i informacionit të mbrojtjes së PAK plotësohet nga institucioni rezidencial ose komunitar në formatin e paraqitur në proçesvebalin 1. Ky informacion referohet në Zyrën Rajonale të SHSSH ose në Bashkinë/ Komunën në të cilën qendra është në varësi. Zyra rajonale ka përgjegjësi ta raportojë informacionin në SHSSH ose Bashkinë/ Njesine Administrative në të cilën qendra është në varësi.

Formulari 2: Për referimin e ankesave plotësohet nga Zyra rajonale e Shërbimit Social në bashkëpunim me institucionin rezidencial / komunitar dhe Bashkinë/ Njesine Administrative që janë në varësi qendrat.

DOKUMENTACIONI

Qendra Shumwfunksionale Komunitare Devoll, ne perputhje me Manualin per Zbatimin e Standarteve te Sherbimeve te Perkujdesit Shoqeror per Personat me Aftesi te Kufizuar, ofron sherbim te dokumentuar sipas formulareve te percaktuar ne kete manual.
Formularet perkates jane:

A. Formulari per mbledhjen e informacionit e nevojshem.

Ky formular siguron te gjitha te dhenat e PAK nepermjet 11 zerave te vecante, duke filluar qe nga gjeneralitetet e perfituesit te sherbimit, diagnoza, shqetesimet e prindit/kujdestarit, llojet e semundjeve te mundshme qe shoqerojne diagnozen, pagesa e aftesise se kufizuar, largimi nga institucioni dhe firmosja nga gjithe pjestaret qe kane te drejten ligjore te plotesojne formularin dhe te kujdesen per PAK, etj.

B. Raport për Vlerësimin e Nevojave dhe Ecurinë për PAK (RVNE).

Raporti për Vlerësimin e Nevojave dhe Ecurisë (RVNE) është një dokument që shërben për të menduar, mbajtur shënime dhe për të analizuar nevojat dhe ecurinë e PAK. Ky raport ndihmon në praktikën e punës sociale profesionale. Provat merren nga diskutimet me anëtarët e familjes të PAK kujdestarët dhe profesionistët e qendrës. Qëllimi i shqyrtimit të nevojave dhe ecurisë së PAK, shihet si pjesë thelbësore e proçesit të vlerësimit. Çdo deklarim shoqërohet me një kuti Po dhe Jo me pjesën shënime dhe të dhëna të tjera. Punonjësit socialë duhet ta mbajnë shënime për vlerësimin e PAK nga profesionistët. Raporti për Vlerësimin e Nevojave dhe Ecurisë shërben si mjet për vlerësimin dhe planifikimin e shërbimeve.
Me qëllim që të monitorohet ecuria e PAK, me kalimin e kohës, plotësohen vlerësimet e përmbledhura të progresit.Perfundimet e procesit te vleresimit dhe informacioni pasqyrohet ne raportin perfundimtar dhe nje kopje e tij I jepet klientit.

C. Plani i Kujdesit

Plani I kujdesit shërben për realizimin e të ardhmes në një periudhë fatgjatë për PAK dhe lidhet ngushtë me vlerësimin e nevojave të klientëve. Plani i Kujdesit duhet të plotësohet brenda dy muajve pas pranimit të PAK në qëndër. Në institucion caktohet një ekip me personel të specializuar, për kryerjen e proçesit të planifikimit të
kujdesit për çdo PAK. Gjithashtu, duhet të përcaktohen objektiva të qarta për çdo individ dhe duhet të jetë e qartë cili është përgjegjës për realizimin e këtyre objektivave.

LEHTESITE QE OFRON QENDRA
Kriteret e perzgjedhjes se perfituesve te sherbimit

Kriteret për pranimin e Personave me Aftësi të Kufizuara në Qendrën Shumefunksionale Komunitare Devoll.

Personat me aftësi të kufizuar përfshijnë ata që kanë dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore aftagjata të cilat në ndërveprim me barriera të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në baza të barabarta me të tjerët. (Konventa per te Drejtat e Personave me Aftesi te Kufizuara, 2006)

"Persona me Aftësi të Kufizuar janë ata persona për të cilët funksionet fizike, kapaciteti mendor ose gjendja psikologjike kanë prirje të shmangen, për me shumë se

Në përputhje me V.K.M, Nr. 425, date 27.06.2012 "Për përcaktimin e kritereve dhe dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave me aftësi të kufizuara në institucionet rezidenciale, publike dhe jo publike të përkujdesjes shoqërore (Kreu II), si dhe në përputhje me Tipologjinë e Qendrës Ditore, kriteret e përzgjedhjes janë si më poshtë vijon:

Kritere shtrenguese:

a. Fëmijë me aftësi të kufizuar intelektuale dhe mendore:
   Fëmijë me autizëm
   Fëmijë me çrregullime të të nxënit
   Fëmijë me sindroma si Down Syndrome

b. Fëmijë me aftësi të kufizuar fizike (paraplegjike, tetra-plegjike, hemiplegjike, etj.)
c. Femijë me dëmtime shqisore (nuk përfshihen fëmjët me dëmtim të plotë të shikimit ose dëgjimit pasi këta fëmijë marrin shërbim në shkollat speciale)

d. Fëmijë të moshës 3 – 16 vjeç (per shkak te kerkeses se madhe te familjeve me femije me aftesi te kufizuar femijet e te cileve jane nen moshen 6 vjec, si dhe duke marre parasysh domosdoshmerine dhe benifitet e nderhyrjes ne moshen e hereshme, mosha e pranimit te femijeve eshte ndryshuar ne 3-16 vjec).

e. Fëmijë të cilët nuk frekuentojnë çerdhet, kopshtet apo shkollat për shkak të rëndesës së aftësisë së kufizuar

f. Fëmijë të cilët nuk frekuentojnë insitutucione ose qendra të tjera publike ose private të përkujdesjes shoqërore

g. Fëmijë të cilët vijnë nga familje me gjendje ekonomike jo të mirë

h. Fëmijë me status familjar jo të favorshëm (prindër të divorcuar, kujdestari nga familjarë, prindër PAK ose me probleme të tjera të rënda shëndetësore që cënojnë prindërimin)

Në rastin kur Qendra Komunitare ka mundësi të rrise numrin e përfituesve dhe numri i përfituesve që plotësojnë kriteret e mësipërme ka shterur, atehere do të merren parasysh edhe kriteret e mëposhtëme (të nënvizuara) të cilat zgjerojnë këtë numër:

Kritere te zbutura

- Fëmijë me vështirësi të të nxënit
- Fëmijë me çrregullime emocionale
- Fëmijë me çrregullime te gjuhës dhe komunikimit
- Fëmijë të cilët frekuentojnë shkollën me orar të plotë ose të pjesshem
- Fëmijë të cilët vijnë nga gjendje ekonomike mesatare
- Fëmijë me status familjar të favorshëm (jo prindër të divorcuar, etj.)

4. Lehtesite e ofruara per sigurine

Qendra Shumëfunksionale Komunitare Devoll do te ofroje sherbime per PAK per te dyja gjinite me moshe te re deri ne 18 vjec,. Perzgjedhja e PAK qe do te vendosen ne qender percaktohet ne baze te kritereve te vendosura nga SHSSH dhe procedurave te parashikuara ne kete manual. Ne varesi me vleresimin e bere nga ekspertet drejtuesja e qendres organizon punen dhe merr masa qe kerkojne:

- Mbikqyrje te drejtperdrejte te veprimtarive te PAK.
- Mbeshtetje per kujdesin personal te PAK si pastrimin dhe vajtjen ne tualet,veshjen,ngrenien etj.
- Marrjen e masave qe dyert e jashtme te mbahen te kycura dhe merren masat e nevojshme per mbrojtjen nga zjarri.
- Merren masa qe muret rrethuese te jene te sigurta dhe porta e jashtme e ambjentit te jete e kycur.
- Te rinjte mund te vijne dhe te ikin vete nga qendra vetem nese personi mbikqyres deklaron me shkrim largimin vete,ne te kunder te rinjte nuk lejohet te dalin jashte territorit te qendres pa personin mbikqyres.
- PAK inkurajohen qe te marrin pjese ne veprimtari dhe programe qe nxisin shprehite per aftesimin e tyre per nje jete sa me te pavarur qe te jete e mundur ,si udhetime,psonisje ,gatim dhe kujdes personal.
- Inkurajimin e perdorimit te hapesirave te perbashketa ku PAK do te mundesohen te shpenzojne kohen ne veprimtarite sociale,argetuese dhe te mesuarit.

5. OFRUESIT E SHËRBIMEVE

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

BASHKIA DEVOLL

Qendra Shumëfunksionale Komunitare Devoll

Adresa : Lagjjia 1. Rruga e Kalase. Nr 12. 7006

6. PERBERJA DHE PROFILI I STAFIT, PERSHKRIMI I DETYRAVE DHE ORGANIKA

Personeli i Qendrës Shumëfunksionale Komunitare Devoll perbehet nga:

- 1 Përgjegjës
- 2 Punonjës Social
- 1 Psikolog
- 1 Fizioterapist
- 1 Guzhinjer
- 3 Punonjëse lehtësuese
- 2 Mesues Ndihmes.

Te pergjithshme:

Ne lidhje me perberjen e stafit, eshte e rekomandueshme qe personeli qe perzgjidhet te jete me kualifikim nga :

1. Pedagogjia Speciale (Specialist/Edukator) te jete figura kryesore. Ne mungese te aplikuesve me keto kualifikime, mund te perzgjidhen persona me formim nga:
2. Psikologjia Shkollore
3. Sociologjia
4. Pedagogjia e pergjithshme

Figurat e mesiperme do te jene njesoj te perfshira ne realizimin e programeve ditore te qendres.

Nderkohe per problemet motorrike, rehabilituese, autonomine dhe higjenen personale dhe terapine okupacionale, do te kene peshen kryesore:

5. Fizioterapisti
6. Terapisti i zhvillimit

Ne te gjitha rastet, keshillohet qe stafi te kete njohuri/trajnim ose pervoje nga Metoda e Analizës së Sjelljes së Aplikuar e cila ne Udhezuesit Nderkombetare dhe Evropiane renditet si terapia e

pare, e provuar shkencerisht e suksesshme per Autizmin, si dhe me rezultate te mira per AKI, Sindromen Down, etj.

I. Punonjësi Social

Funksionet kryesore dhe detyrat specifike të Punonjësit Social në Qendrat Ditore ne zbatim te rregullores se Bashkise.

- Vendos marrëdhënie midis qendrës ku ofrohen shërbimet, familjet dhe komunitetit për ruajtjen, zhvillimin dhe integrimin e PAK
- Mban çdo lidhje me familjen dhe e informon atë për rezultatet dhe nevojat e PAK gjatë shërbimeve në qendër.
- Vlerëson gjëndjen social-ekonomike, kushtet e banimit si dhe marrdhëniet sociale brenda dhe jashtë familjes, duke grumbulluar informacion për PAK.
- Merr pjesë në diskutimet e rasteve duke ofruar vlerësimet e PAK dhe familjes së tij në aspketin psiko-social.
- Ndan dhe diskuton me anëtarët e ekipit multidisiplinar informacionin e nevojshëm për klientin.
- Gjatë punës në ekip, jep mendime mbi vlerësimin e nevojave në aspektin edukativ, shëndetësor dhe argëtues për PAK.
- Në bashkëpunim me specialistë të tjerë dhe kujdestarët, programon planin e kujdesit për shërbime social-edukative dhe emocionale të PAK.
- Ndihmon në krijimin dhe mirëmbajtjen e dosjes personale të PAK duke grumbulluar informacionin e duhur për ekuilibrin psiko-social.
- Në qendrat për PAK, punonjësi social implementon programe të planit të kujdesit si:
    - menaxhimin e sjelljeve të papranueshme
    - rritjen e kapaciteteve informative në fusha të ndryshme
    - organizon dhe drejton tema sociale të rëndësishme për këtë target grup me problematika të tërheqjes dhe pjesmarrje aktive të PAK
    - ndihmojnë PAK të eksplorojnë interesat e tyre, të zhvillojnë talentet dhe pavarësinë, të rrisin vetë-vlerësimin dhe të mësojnë si të sillen me të tjerët në situata të ndryshme
- Organizon dhe menaxhon aktivitete argëtuese që nxisin zhvillimin fizik, emocional, intelektual dhe social të PAK, si brenda insitucionit dhe jashtë tij.
- Menaxhon aktivitete sportive të PAK sa herë ato organizohen në komunitet.
- Punon në komunitet për të sensibilizuar opinionin publik për problemet dhe nevojat e PAK.
- Krijon rrjetin e mbështetjes për PAK në komunitet duke vendosur marrëdhënie midis qendrës ku ofrohen shërbimet, qendrave të tjera simotra, kopshteve dhe shkollave të komunitetit, Njësisë Bashkiake, Shërbimit Social Shtetëror, apo dhe organizatave simotra brenda dhe jashtë vendit që operojnë në të njëjtën fushë, etj.

- Interesohet për PAK nëse frekuenton kopshte, shkolla, merret me punë, duke ndjekur ecurinë e tyre në mënyrë të rregullt dhe periodike.
- Organizon ose ndjek aktivitete sportive, kulturore që organizon komuniteti për këtë kategori.

Kualifikimet kryesore të kërkuara:

- Arsimi i lartë, Fakulteti i Shkencave Sociale;
- Njohuri të mira të kuadrit ligjor për fëmijë;
- Ai/Ajo duhet të ketë jo më pak se 2 vjet eksperiencë pune;
- Njohuri të mira në programet kompjuterike;
- Aftësi të shkëlqyera në komunikim, ndërmjetësim dhe intervistim si dhe aftësi të provuara të punës në grup;
- Të ketë eksperiencë specifike në menaxhimin e rasteve;
- Njohuri/përvojë/trajnime mbi Terapinë e Sjelljes së Aplikur, Terapinë e Zhvillimit dhe të Lojës (e preferueshme).

II. Psikologu

Funksionet kryesore të veprimtarisë së psikologut

Psikologu është një nga anëtarët më të rëndësishëm të ekipit multidisiplinar. Ai është përgjegjës për shërbimet e ofruara në qendrat për zhvillim dhe integrim. Duke e konceptuar punën me individin si të pandarë nga rrethi dhe komuniteti, funksionet dhe detyrat e psikologut në qendër janë të lidhura ngushtë si më poshtë:

Ofron trajtimin terapeutik dhe psikoterapeutik për përdoruesit e shërbimit

- Ofron teknika të trajtimit terapeutik për përdoruesit në bazë të PEI në fushën e konjicionit, të problemeve psikoemocionale dhe problemeve të sjelljes.
- Kryen këshillim psikologjik
- Kryen mbështetje emocionale për përdorues që e kanë të nevojshme.
- Ndërhyn në situata të sjelljes ekstreme nga përdorues të ndryshëm.
- Jep teknika dhe terapi për modifikimin e sjelljeve jo të përshtatshme.

Roli i psikologut me familjen e përdoruesit të shërbimit

- Merr kontakte me kujdestarin dhe anëtarët e tjerë të familjes
- Analizon çdo marrëdhënie të klientit me anëtarët e tjerë të familjes

- Analizon marrëdhëniet e anëtarëve ndërmjet tyre duke analizuar ndikimin e tyre te përdoruesi
- Vlerëson faktorë të tjerë familjar (abuzim, hiperproteksion, neglizhim) që mund të kenë ndikim në problemet e personave me AK
- Vlerëson gjendjen psikoemocionale të kujdestarit
- Udhëzon dhe informon kujdestarin për çdo problem të rëndësishëm të përdoruesit të shërbimit
- Planifikon dhe realizon ndërhyrjen psiko-edukative në familje
- Jep këshillime për kujdestarin me qëllim largimin e stresit, stigmës, etj.
- Jep mbështetje psiko-emocionale për të, duke krijuar grupe mbështetje me prindër me qëllim: lehtësimin e streseve, ndarje eksperiencash të përbashkëta , etj.

Kualifikimet kryesore të kërkuara:

- Arsimi i lartë, Fakulteti i Shkencave Sociale, dega psikologji
- Njohuri të mira të kuadrit ligjor për cështjen e aftësisë së kufizuar;
- Ai/Ajo duhet të ketë jo me pak se 2 vjet eksperiencë pune;
- Njohuri të mira në programet kompjuterike;
- Aftësi të shkëlqyera në komunikim, ndërmjetësim dhe intervistim si dhe aftësi të provuara të punës në grup;
- Të ketë eksperiencë specifike në menaxhimin e rasteve;
- Njohuri/përvojë/trajnime mbi Terapinë e Sjelljes së Aplikur, Terapinë e Zhvillimit dhe të Lojës (e preferueshme).

Mesues Ndihmes

- Të ndihmojë nxënësit në përmbushjen e detyrave shkollore
- Të lehtësojë procesin e të nxënit jashtë orarit të shkollës
- Të kontribuojë në zhvillimin akademik, social dhe emocional të fëmijëve
- Të krijojë një mjedis të sigurt, motivues dhe pozitiv
- Ndihmon nxënësit në kryerjen e detyrave të shtëpisë
- Shpjegon koncepte mësimore sipas nivelit të nxënësit
- Ndihmon në përforcimin e shkrim-leximit, matematikës dhe lëndëve të tjera
- Përdor metoda të thjeshta dhe praktike për të lehtësuar të nxënit
- Nxit nxënësit të punojnë në mënyrë të pavarur
- Asiston gjatë aktiviteteve kreative, sportive dhe edukative
- Ndihmon në organizimin e lojërave dhe punëtorive
- Siguron përfshirjen e të gjithë nxënësve në aktivitete

Kualifikimet kryesore te kerkuara

- Diplomë universitare në **Arsim, Shkenca Sociale, Psikologji, Edukim Parashkollor/Fillor,** ose fusha të ngjashme
- Njohuri bazë të kurrikulës shkollore (sidomos arsimi fillor)
- Aftësi për të ndihmuar në detyrat e shtëpisë dhe mësimin përforcues
- Trajnime ose kurse në:
    - Metodologji mësimdhënieje
    - Punë me fëmijë
    - Edukim joformal / after school (avantazh)

Fizioterapisiti

Fizioterapisit ka për detyrë kryesisht të reduktojë defiçitet motorrike të lindura ose të fituara gjatë fëmijërisë së herëshme apo gjatë moshës më të rritur. Nëse defiçitet motorrike shoqërohen edhe me defiçite mendore, terapia është e kombinuar dhe quhet terapi psikofizike. Fizioterapistët duhet të kenë edukim special në fushën që mbulojnë. Ata duhet të njohin mirë anatominë dhe fiziologjinë e funksionimit të trupit të njeriut. Gjithashtu duhet të njohin mirë psikologjinë e moshave të ndryshme (fëmijëve dhe më të moshuarve) që terapia të jetë e pranueshme dhe të mos refuzohet prej tyre. Duhet të jenë fizikisht të shëndetshëm dhe të përballojnë ngarkesa fizike gjatë trajtimit të klientëve të tyre.
Fusha e veprimtarisë së tyre më e zakonshme është AK fizike dhe AK mendore-fizike.

Funksionet:

Në qendrat e PAK, fizioterapia zhvillohet në një mjedis të përshatshëm si palestër ose dhomë e madhe që duhet të jetë e pajisur me mjete të shumta si dyshek, shtrat, biçikleta statike, shkallë suedeze, susta, gira, etj.

- Në mënyrë të detajuar fizioterapisti vlerëson funksionimin e PAK duke observuar atë në situate të ndryshme si dhe në ushtrime tip.
- Përcakton problemet me deformimete kyçeve, anësive, kolonës dhe shkallën (gradacionin) e shmangies apo deformimit.
- Përcakton tonusin muscular.

- Vlerëson aftësinë për të qëndruar shtrirë, ulur apo në këmbë. Aftësinë për të lëvizur, për të ecuar, vrapuar, ngjitur shkallët, mënyrën e ngjitjes së tyre, etj.
- Vlerëson aftësinë për të mbajtur ekuilibrin.
- Aftësitë për të kryer koordinimet sy-dorë, dëgjim-lëvizje, lëvizje me lëvizje, etj.
- Aftësitë për të mbajtur ritmin.
- Organizon punën me PAK përherë në bashkëpunim të ngushtë me specialistë të tjerë të fushës si mjekë, neurologë, terapistë okupacionalë,psikologë, etj.
- Fizioterapisti plotëson raportin e nevojave motorrike si dhe planin e kujdesit.
- Në punën në grup, fizioterapisti harton pjesë të PEI që ka lidhje me psikomotricitetin.
- Ai vendos objektiva të qarta hap pas hapi në funskion të përmirësimit të motorrikës globale, fine, koordinimit, zbutjes së spazmave, qëndrimet në pozicionet normale, etj.
- Përcakton ngarkesën ditore të ushqimeve, mjetet që duhet të përdoren, vendi ku do të kryeht terapia, etj.
- Implementon së bashku me asistent-fizioterapistin hap pas hapi programin e hartuar.
- Fizioterapsiti kryen proçedura të terapisë fizike dhe ofron shërbime që ndihmojnë në përmirësimin e lëvizjeve dhe çlirimin e dhimbjeve.
- Fizioterapsiti përpiqet të zbatoj normat e kodit etik për PAK, të përdor fjalor të përshatshëm, të jetë i kujdeshsëm gjtë ushtrimeve për të krijuar marrëdhënie të drejta bashkëpunimi me PAK.
- Fizioterapisit mundohet të përdor teknika që të motivojnë PAK për të mos refuzuar terapinë dhe për të bashkëpunuar me të.
- Për fëmijët ai ndërthur lojën dhe ushtrimet që ora të jetë sa më e këndëshme për ta.
- Në bashkëpunim me terapistin okupacional dhe familjarin përcaktohen të gjitha mënyrat sesi do të trajtohet PAK në kushtet e familjes.
- Puna e fizioterapistit mbështetet te ndihma e familjes.
- Ai jep këshilla të vazhdueshme për trajtimin në familje: përdorimin e mjeteve ndihmëse, pozicionet trupore, qëndrimin në karrige, në shtrat, njgitje dhe zbritje të shkallëve, vendosjen në tualet, etj.
- Fizioterapisit i mëson kujdestarit edhe teknika të thjeshat të terapisë që mund të aplikohen në familje në formë loje, gjatë ngrënies, orës së TV, etj.

Kualifikimet kryesore të kërkuara

- Arsimi i lartë, të preferueshëm: Pedagogjia Speciale/ Fizioterapia
- Njohuri të mira të kuadrit ligjor per personat me aftësi të kufizuara;
- Ai/Ajo duhet të ketë jo me pak se 2 vjet eksperiencë pune;
- Njohuri të mira ne programet kompjuterike;
- Aftësi të shkëlqyera në komunikim, ndërmjetësim dhe intervistim si dhe aftësi të provuara të punës në grup;

- Njohuri/përvojë/trajnime mbi terapinë e sjelljes së aplikur, terapinë e zhvillimit dhe të lojës (e preferueshme)

Punonjes Ndihmes

Punonjësi lehtësues mbështet fëmijët dhe stafin e qendrës në zhvillimin e aktiviteteve edukative, sociale dhe rekreative, duke kontribuar në krijimin e një mjedisi të sigurt, gjithëpërfshirës dhe zhvillues për fëmijët.

Detyrat dhe përgjegjësitë

- Mbështetje educative
- Lehtësimi i aktiviteteve në qendër
- Mbështetje sociale dhe emocionale
- Bashkëpunimi dhe komunikimi

Kualifikimet për Punonjës Ndihmes

Diplomë universitare ose studime në vazhdim në **Arsim**, **Edukim Fillor/Parashkollor**, **Shkenca Sociale**, **Psikologji**, **Punë Sociale**, ose fusha të ngjashme.

- Njohuri bazë mbi zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve
- Aftësi për lehtësimin e aktiviteteve edukative, sociale dhe kreative
- Njohuri bazë të kurrikulës shkollore (avantazh)
- Trajnime ose kurse në:
- Punë me fëmije
- Edukim joformal / qendra ditore / after school (avantazh)

10. Kontrolli dhe disiplina

Kontrolli dhe disiplina ne QS-QK per PAK mbeshtetet ne forcimin pozitiv te sjelljes nepermjet zhvillimit te bisedave me PAK duke I trajtuar me dinjitet ne kohen e duhur.

Njohja e gjendjes dhe e sjelljeve te PAK krijon mundesi per te ndertuar programe individuale te kujdesit qe lidhen me permiresimin e sjelljes.Per kete rekomandohet te shfrytezohet dhe koha e

lire ,duke angazhuar nje punonjes I cili nderhyn me kujdes per te kapercyer situaten duke permiresuar gjendjen.

12.Mbrojtja nga zjarri dhe procedurat e emergjences